




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT PËR VITIN 2021

Prishtinë, maj 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut (Mitrovica e Veriut), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna edhe në vitin 2021 pasuritë jo financiare kapitale nuk kishte arritur ti regjistrojë në regjistrin kontabël SIMFK, pasuritë e pa regjistruara janë; ndërtesat publike, rrugët dhe tokat. Kjo çështje është trajtuar në auditimin e kaluar dhe janë bërë rekomandimet e duhura, por nuk është ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim, Menaxhmenti i komunës ka deklaruar arsyet dhe problemet në regjistrimin e pronës si dhe arsye të tjera administrative.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komuna e Mitrovicës së Veriut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në rastin e dy kontratave të nënshkruara ndërmjet OJQ-ve dhe komunës në vlerë prej 9,300€, nuk janë dorëzuar raporte financiare dhe narrative për shpenzimet e bëra, siç është përcaktuar me kontratë dhe Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.
- B2 Komuna nuk ka planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë në buxhetin e vitit 2021 sepse ende nuk kanë arritur të formojnë një shërbim të tatimit në pronë (nuk kanë menaxher të tatimit në pronë, as zyrtarë të anketimit, apo zyrtarë të trajnuar për përdorimin e sistemit të protaxit etj.). Gjithëashtu, nuk kanë bërë identifikimin e pronës në menyrë që më pas të bëjnë regjistrë të pronës. Edhe pse procesi i inventarizimit të pronave filloj në vitin 2014, me mbështetjen e Agjencisë Katastrale të Kosovës, Komuna ende nuk ka përfunduar atë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Mitrovicës së Veriut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Mitrovicës së Veriut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Mitrovicës së Veriut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur se sistemi i kontrollit të brendshëm në Komunën e Mitrovices Veriore në disa fusha nuk është në nivelin e duhur. Fushat për përmirësim të mundshëm janë si: korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat vjetore financiare, mos mbledhjen e te hyrave tatimit ne pronë, pagesa e obligimeve të pa specifikuara, mos raportimi i subvencioneve nga perfituesit menaxhimi i pasurive jo financiare mos regjistrimi i pronave, tokave në regjistra kontabel SIMFK, dhe mos kompletimi i NJAB-se të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve dhe kërkojnë veprime të menjëhershme për të parandaluar dëme të mëtutjeshme të buxhetit të Komunës.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (8) rekomandime, prej tyre dy (2) është rekomandim i ri, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Regjistri jo i saktë i pasurive në shpalosjet e PFV

Gjetja Rregullorja e MF - nr. 02/2013, Neni 6, mbi Menaxhimin e pasurive jo-financiare në organizatat buxhetore kërkon që secila organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe përditësojë regjistrin e pasurive jo-financiare që e menaxhon. Regjistri duhet të mirëmbahet veçmas për secilën pronë dhe në formë të përmbledhur sipas kategorive të klasifikuara bazuar në planin e kontabilitetit. Rregullorja gjithashtu specifikon që pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuritë jo-kapitale duhet të regjistrohen në e-pasuri.

Në vitin 2021, komuna ka dështuar të regjistrojë të gjitha pasuritë kapitale jofinanciare në regjistrin kontabël (SIMFK), pasuritë e paregjistruara janë: ndërtesat publike, rrugët dhe toka. Kjo çështje është trajtuar në auditimin e kaluar dhe janë bërë rekomandimet e duhura, por nuk është ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim, Menaxhmenti i komunës ka deklaruar arsyet dhe problemet në regjistrimin e pronës si dhe arsye të tjera administrative.

Arsyeja është se komuna ende nuk ka nisur procedurën e inventarizimit dhe vlerësimit të plotë të pronës që zotëron. Prandaj, nuk ka garanci të plota lidhur me vlerën e asetëve komunale të paraqitura në PVF-të e vitit 2021.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive e bën të vështirë për komunën menaxhimin dhe përdorimin me sukses të pasurisë në mënyrë që të marrin vendime racionale që do të ishin në interes të të gjithë qytetarëve. Gjithashtu, të dhënat dhe informatat jo të plota në regjistrin e pasurisë rezultojnë me paraqitje të pasaktë në PVF.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që të kryhet një analizë për të përcaktuar shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurive. Nevojitet një veprim i veçantë për të adresuar arsyet në mënyrë sistematike për të mënjanuar mangësitë në identifikimin dhe regjistrimin e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mos raportimi i fituesve mbi koston e subvencioneve të dhëna

Gjetja

Në bazë të Rregullores MF nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, neni 23. Monitorimi dhe raportimi për projektet dhe programet në të cilat përfituesi i grantit raporton te zyrtari monitorues, në baza të rregullta në lidhje me zbatimin/programin i projektit siç parashikohet në kontratën e parashikuar në nenin 22 të kësaj rregulloreje. Raportimi përfshin raportimin narrativ dhe financiar dhe periudhat e raportimit do të përcaktohen në përputhje me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Në rastin e dy kontratave të nënshkruara ndërmjet OJQ-ve dhe komunës në vlerë prej 9,300€, nuk janë dorëzuar raporte financiare dhe narrative për shpenzimet e bëra, siç është përcaktuar me kontratë dhe Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrollit mbi monitorimin e subvencionit të dhënë nga zyrtarët komunal dhe mospërmbushjes së obligimeve të përcaktuara me kontratë nga përfituesi i subvencionit.

Ndikimi

Mungesa e raportimit të përfituesit të subvencioneve për shpenzimet e bëra mund të rezultojë në keqpërdorim të buxheteve dhe dështim në arritjen e objektivave komunale.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të ndërmarrë hapa në përputhje me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve, me theks të veçantë në raportimin e përfituesve për shpenzimin e subvencioneve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos zbatim i ligjit për mbledhjen e të hyrave (Te hyrat nga tatimit në pronë)

Gjetja

Neni 2 i ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pasuri të paluajtshme thotë qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të mbledhë të hyrat nga tatimi në pronë komuna për vitin 2021 nuk kishte filluar për grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë.

Komuna nuk ka planifikuar të hyrat nga tatimi në pronë në buxhetin e vitit 2021 sepse ende nuk kanë arritur të formojnë një shërbim të tatimit në pronë (nuk kanë menaxher të tatimit në pronë, as zyrtarë të anketimit, apo zyrtarë të trajnuar për përdorimin e sistemit të protaxit etj.). Gjithëashtu, nuk kanë bërë identifikimin e pronës në menyrë që më pas të bëjnë regjistrë të pronës. Edhe pse procesi i inventarizimit të pronave filloi në vitin 2014, me mbështetjen e Agjencisë Katastrale të Kosovës, Komuna ende nuk ka përfunduar atë.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna ende nuk ka krijuar një politikë për zbatimin e ligjit dhe nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për mbledhjen e të hyrave nga këto aktivitete që kanë një ndikim të rëndësishëm në nivelin e buxhetit komunal.

Për më tepër, nga aspekti i auditimit, çështja dhe rekomandimi është

përsëritur ndër vite, megjithatë nga komuna nuk ka shenja për ndërmarrjen e masave konkrete.

Ndikimi

Mos zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve për mbledhjen e tatimit në pronë, ka ndikim të rëndësishëm dhe prioritar, duke shtuar faktin këtu, që tatimi në pronë është i vetmi tatim i decentralizuar në nivelin komunal. Në këtë mënyrë, të hyrat nuk realizohen, gjë që ndikon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të komunës ku të hyrat janë bazë e financimit.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatimin në Pronë, si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave. Gjithashtu, Kryetari duhet ta bëjë funksional shërbimin komunal të tatimit në pronë dhe përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë vetë qytetarët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Kontrollat e brendshme në raportimin financiar

Çështja A2 - Dobësitë në përgatitjen e PVF-ve

Gjetja	<p>Rregullorja e MF - nr. 01/2017 për raportimin vjetor financiar të Organizatës Buxhetore, dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik“ Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.</p> <p>Në Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës, neni 13- Pasqyra e Pranimeve dhe pagesave në para të gatshme-burimi i fondeve pranimet, financimi i shpenzimeve nga huamarrja, në vlerë prej 6,000€, është prezantuar si burim i financimit pranimet tjera. Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit hyrja e paras në LLVTH në kolonën realizmit, të hyrat nga donacionet janë prezantuar në vlerë 0,00€, është dashtë të prezantohen në vlerë prej 15,000€.</p> <p>Në kolonën buxheti final është prezantuar buxheti nga Fondi zhvillimor i mirëbesimit në vlerë prej 4,081,000€, është dashtë të prezantohet te pjesa dalëse e parasë nga LLVTH në kolonën buxheti final -kategoria e investimeve kapitale, dhe shënimet shpjeguese nuk ishin prezantuar në vlera të sakta dhe të plota.</p> <p>Përgatitja e PVF-ve nga Komuna nuk është bërë në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores nr. 01/2017 për raportim financiar. Pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave nga auditimit, Komuna kishte ndërmarrë veprime dhe kishte bërë korrigjimet e nevojshme dhe versioni i korrigjuar i PVF-ve ishte përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, dhe i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga korniza ligjore për raportim.</p> <p>Mungesa e funksionimit të sistemit kontrollit të brendshëm.</p>
Ndikimi	<p>Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i informatave financiare dhe jo financiare në PVF, nuk paraqet pamjen e vërtetë dhe të saktë të të dhënave dhe ulë shkallën e besueshmërisë të përdoruesit e synuar.</p>
Rekomandimi A2	<p>Kryetari duhet të shtoj kontrollat gjatë hartimit të PVF në mënyrë që shpalosjet në PVF-të për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollat e nevojshme sipas draft PVF - ve.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 2,727,672€, janë shpenzuar 2,727,522€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 857, ndërsa numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 530. Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur rekrutime të reja. Ne kemi testuar 27 mostra për teste substanciale në vlerë prej 40,038€, si dhe gjashtë (6) mostra për teste të pajtushmërisë.

Çështja B3 - Sfidat në menaxhimin e burimeve njerëzore

Gjetja

Menaxhimi i burimeve njerëzore synon të koordinojë aktivitetet e organizatës në mënyrë që të sigurojë funksionimin e sistemit në përputhje me politikën e administratës komunale dhe kuvendit komunal që zbatohen në të gjithë organizatën. Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin: Dizajnimin dhe auditimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e detyrave, kontrollin e shpenzimeve buxhetore të stafit dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit, duke përfshirë matjen e performancës së stafit duke vlerësuar performancën e stafit.

Komuna ka përpiluar një draft rregullor të brendshme për strukturën organizative, mirëpo ky draft ende nuk është finalizuar, arsyet e mos finalizimit sipas menaxherit të burimeve njerëzore është se sa i përket procedurës së vënies në fuqi të këtij dokumenti, ekzistojnë ende pengesa të karakterit teknik përfshirë këtu buxhetin dhe mundësitë financiare. Ky shqetësim sipas menaxheres së burimeve njerëzore është diskutuar disa herë me perfaqësuesit e Autoriteteve Qendore ku dhe shpresojmë se do të punojnë se bashku për të arritur një zgjidhje adekuate.

Në bazë të planit të veprimit, si dhe njoftimeve të punëtorëve, për shkak të pandemisë Covid-19, Kuvendi i Komunës nuk ka mundur të mbajë seanca dhe të miratojë rregullore për strukturën organizative.

Ndikimi

Mungesa e strukturës organizative të stafit nuk ofron siguri për organizimin e brendshëm të Komunës, me rastin e ndarjes së detyrave dhe vendeve të caktuara të punës, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që të merren veprimet e duhura për të adresuar urgjentisht problemet e përmendura më lartë, në mënyrë që Komuna të ketë të vendosur një strukturë të përshtatshme dhe mirë-organizuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë, në vitin 2021 ishte 558,895€, prej të cilave janë shpenzuar 494,529 € ose 88%. Pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë për: prokurimin e derivateve 47,865€, pajisjet e zyrës (nën 1,000 €) 227,899€, pajisjet tjera 123,765€. Ne testuam pesë (5) mostra për teste të detajuara me vlerë 95,135€, si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Pagesa e faturave të paspecifikuara

Gjetja

Pagesa e ujit është e rregulluar me Ligjin për ujërat 04/L-147, respektivisht me Udhëzimin plotësues Administrativ 02/2016 për Strukturën e pagesave të ujit. Ndërsa çështja e kërkesave të parashkruara është e rregulluar me Ligjin 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 320.

Në dhjetor 2020, Komuna ka pranuar dhe ka regjistruar një faturë në vlerë prej 58,837€ nga Ujësjiellësi Rajonal "Mitrovica" për konsum të ujit për periudhën 01- 30.11.2020. Bazuar në faturën e pranuar dhe kartelën financiare të blerësit të datës 15.12.2020 dhe në bazë të shkresës së Ujësjiellësit Rajonal për shumën e borxhit të komunës dhe objekteve komunale, komuna ka paguar borxhin e mbetur për konsumin e ujit më datë 09.02. 2021 në vlerë 14,337€. Faturat nuk janë të specifikuara dhe nuk tregojnë të dhëna të qarta për kostot e klientëve (objektet komunale) individualisht. Kompania nuk i dorëzon fatura komunës në baza mujore, prandaj komuna nuk e ka deklaruar këtë faturë si detyrim (në pasqyrën e detyrimeve) për vitin 2021.

Kjo ka ndodhur, sipas komunës, për të mos mbetur asnjë shfrytëzues pa ujë, komuna është dashur të shlyejë borxhet për përdoruesit e apo institucionet publike, të cilat i financon. Përkundër faktit se komunës nuk i janë ofruar fatura në baza mujore dhe për borxhin në faturën e pranuar, komuna nuk ka një pasqyrë të saktë të obligimeve të saj për t'i paraqitur ato në raport.

Ndikimi

Pagesa e ujit, e cila nuk ishte regjistruar si detyrim i komunës, rrezikon që detyrimet e paguara nga komuna të mos evidentohen si të paguara apo edhe të jenë paguar detyrime që nuk i takojnë komunës.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë që pagesat për shpenzimin e ujit të bëhet vetëm për faturat të specifikuara dhe të tregojnë të dhëna të qarta për koston e klienteve individualisht.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 244,243€, prej të cilave janë shpenzuar 125,660€ ose 51%. Subvencionet janë ndarë për financimin e OJQ-ve, ndërsa një pjesë e subvencioneve janë shpenzuar për ndihmë sociale dhe trajtim shëndetësor. Ne testuam pesë (5) mostra me vlerë 19,000€.

Çështja C1 - Mos hartimi i planit vjetor për subvencionim

Gjetja	Në përputhje me nenin 6 të rregullores. MF nr. 04/2017 ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin një plan vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të jo më vonë se 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe e paraqesin atë në Zyrën për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit (ZK) dhe neni 26 - secili ofruer i mbështetjes financiare pas përgatitjes së raportit vjetor, do ta paraqesë atë jo më vonë se 1 mars.
	Komuna ka dështuar të përgatisë me kohë dhe të dërgojë planin në zyrën përkatëse për qeverisje të mirë në ZK dhe të njëjtin plan ta publikojë në web faqen e Komunës.
	Arsyeja për këtë është mungesa e kontrolleve efektive në plotësimi i kërkesave për përgatitjen e planit vjetor të subvencionimit dhe plotësimi i kërkesave për raportim mbi planin në ZK.
Ndikimi	Mungesa e një plani vjetor të subvencionimit e bën të pamundur në kohën e duhur informimin e palëve të interesuara për programin vjetor dhe synimet që duhen arritur përmes financimit të projekteve.
Rekomandimi C1	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat ligjore për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve janë përmbushur dhe se plani i raportohet ZK-së brenda afatit të caktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Nga organizatat buxhetore kërkohet që të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndihmon organizatën të arrijë qëllimet e saj duke aplikuar një qasje sistematike dhe disiplinore për vlerësimin e biznesit përmes planifikimit të punës së auditimit duke identifikuar dhe vlerësuar natyrën dhe nivelin e rrezikut të lidhur me çdo aktivitet të organizatës.

Çështja B5 - Mungesa e krijimit të njësisë së auditimit të brendshëm

- Gjetja** Neni 19 i Ligjit Nr. 06 / L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike, përcakton themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, komuna ende nuk ka qenë në gjendje të siguroj shërbime të auditimit të brendshëm dhe të njëjtat nuk janë mbuluar nga ndonjë organizatë tjetër.
- Në vitin 2021, Komuna nuk ka shpallur konkurs për auditor të brendshëm, punësimi i të cilit përfshihet në Planin e Personelit për vitin 2021.
- Sipas deklaratës së menaxherit të burimeve njerëzore, pavarësisht tentativës së komunës për shpalljen e konkursit, për shkak të pengesave teknike dhe ndryshimeve në rregulloret ligjore, konkursi nuk është shpallur.
- Ndikimi** Mungesa e auditimit të brendshëm mund të ndikojë në përsëritjen e dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos identifikojë dobësitë në kontrole dhe të reagoj me kohë në eliminimin e tyre.
- Rekomandimi B5** Kryetari duhet të themelojë NjAB, me qëllim që të ofroj mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e Komitetit të Auditimit i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në kemi marrë parasysh burimet e mjeteve buxhetore, shpenzimet nga kategoritë ekonomike dhe mbledhjen e të hyrave. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,996,273	9,031,006	4,705,516	5,894,153	5,170,718
Grante Qeveritare - Buxheti	4,933,588	4,757,195	4,628,511	5,852,090	4,795,398
Financimi përmes huamarrjes	0	6,111	6,111	0	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	4,080,544	0	42,063	319,282
Të bartura nga viti i kaluar	0	109,432	56,266	0	37,181
Të hyrat vetanake	62,685	62,685	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	15,039	14,627	0	18,856

Buxheti final për vitin 2021 është 9,031,006€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 4,034,733€. Diferenca mes buxhetit fillestar dhe atij final është rezultat i rritjes së transfereve të të hyrave vetanake nga viti paraprak (109,432€), të hyrave nga donacionet e jashtme në vlerë prej (15,039€), transfereve të mjeteve nga Fondi për Zhvillim (4,080,544€.) dhe financimi me kredi (6,111€), ndërsa ka pasur zvogëlim nga granti Qeverisë për 176,393€.

Në vitin 2021, komuna ka shpenzuar 52% të buxhetit final, që është një rënie prej 6% krahasuar me vitin 2020 (58%). Zbatimi i buxhetit mbetet i pakënaqshëm, dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë paraqitur më në detaje më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,996,273	9,031,006	4,705,516	5,894,153	5,170,718
Pagat dhe mëditjet	2,897,805	2,727,672	2,727,523	2,760,067	2,491,232
Mallrat dhe shërbimet	512,761	512,895	478,909	990,551	606,692
Komunalitë	46,000	46,000	15,620	46,657	51,453
Subvencionet dhe transferet	162,000	244,243	125,660	90,735	15,950
Investimet Kapitale	1,332,707	5,500,196	1,357,804	2,006,144	2,005,391
Rezervat	45,000	0	0	0	0


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë buxhetore janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë paga dhe mëditje është 2,727,672€, krahasuar me buxhetin fillestar është zvogëluar për 170,133€, janë shpenzuar 99,9%, derisa kanë mbetur donacione të jashtme të pashpenzuara në vlerë prej 149€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunal është 558,895€, krahasuar me atë fillestar është rritur për 134€, ndërsa janë shpenzuar 494,529€ ose 89%.
- Buxheti final për subvencione është 244,243€, krahasuar me buxhetin fillestar të rritur për 82,243€, janë shpenzuar 125,660€ ose 51%. Buxheti Final për subvencione është rritur për shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti 2020 për 82,243€. Realizimi i buxhetit final është ende i ulët, megjithëse ka një rritje në krahasim me vitin e kaluar 2020 me 6.5%. Niveli i ulët i realizimit të buxhetit në këtë kategori vjen si pasojë e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga buxheti final në vlerë prej 62,685€, si dhe të hyrave vetanake të transferuara të pashpenzuara dhe granteve qeveritare.
- Buxheti final për investime kapitale është 5,500,196€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 4,167,489€, prej tyre: mjetet nga Fondi Zhvillimor në vlerë 4,080,543€, granti qeveritar 45,000€, të hyrat vetanake të transferuara në vlerë 27,105€ dhe donacionet në vlerë prej 14,839€. Përkundër rritjes së buxhetit për investime kapitale, janë shpenzuar vetëm 1,357,803€ ose 25% e buxhetit final, që është 8% më pak se në vitin paraprak 2020.

Niveli i ulët i realizimit të investimeve kapitale është pasojë e buxhetit final të pa shpenzuar nga Granti Qeveritar në vlerë prej 51,337€, të hyra të pashpenzuara nga Fondi Zhvillimor në vlerë prej 4,080,544€. Nga ky fond nuk ishte realizuar projekti “Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Veri Mitrovicë” në vlerë 3,500,000€, (pasi që, Operatorit Ekonomikë (OE) i janë bllokuar llogarit bankare për shkak të procesit hetimor të inicuar nga organet e drejtësisë, dhe me këtë rast është arritur marrveshja mes Komunës dhe OE për shkëputje të kontratës në menyrë të dyanshme). Pjesa tjetër ishte për shpronësim të tokës 179,982€, për Institutin Rajonal të Kulturës 399,900€ sid dhe shpenzimeve për zjarrfikës 160€ dhe Sallë sportive 501€. Gjithashtu, mjetet e transferuara nga të hyrat vetanake, të shpërndara në kategorinë e investimeve kapitale prej 27,105€, janë realizuar në vlerë prej 16,806€ dhe donacionet prej 212€.

Si pasojë e situatës së pandemisë Covid-19, komuna për këtë qëllim ka shpenzuar 6,111€ për paga dhe mëditje, pagesat janë bërë nga kategoria paga dhe shtesa.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Komuna ka planifikuar të hyra në vlerë prej 62,685 € për vitin 2021, ka realizuar të hyra në vlerë prej 47,802 €, ndërsa nuk ka realizuar të hyra nga tatimi në pronë. Komuna gjithashtu ka inkasuar të hyra indirekte nga gjobat e policisë në shumë prej 2,824 €.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	62,685	62,685	47,802	38,869	41,297
Të hyrat jo tatimore	62,685	62,685	47,802	38,869	41,297

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të për vitin 2020 për Komunën e Mitrovicës së Veriut ka rezultuar me 11 rekomandime. Komuna ka përgatitur një plan veprimi që tregon mënyrën e zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2021, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, pesë (5) nuk janë adresuar ende, ndërsa një (1) është ende në proces, siç tregohet në grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si ato adresohen, shihni Tabelën 4 (ose tabelën e rekomandimeve).

Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së veriut për vitin 2020, nuk ishte shqyrtuara në Kuvendin Komunal.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që të kryhet një analizë për të përcaktuar shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurive. Nevojitet një veprim i veçantë për të adresuar arsyet në mënyrë sistematike për të mënjanuar mangësitë në identifikimin dhe regjistrimin e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.	Komuna nuk e ka zbatuar këtë rekomandim, situata është e njëjtë me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PVF në mënyrë që shpalesjet në PVF-të për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.	Gjatë auditimit, komuna, pas identifikimit të gabimeve dhe këshillave tona, ka marrë masa dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme dhe është përgatitur një version i rishikuar i PVF-ve në përputhje me standardet.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatimin në Pronë, si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave. Gjithashtu, Kryetari duhet ta bëjë funksional shërbimin komunal të tatimit në pronë dhe përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë vetë qytetarët.	Komuna nuk e ka zbatuar këtë rekomandim, situata është e njëjtë me vitin e kaluar	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët kompetent kanë nivelin e duhur të përgjegjësisë në mënyrë që regjistrimi i të hyrave dhe raportimi i tyre të jetë i rregullt dhe në kohë. Duhet gjithashtu të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet adekuate ekonomike në SIMFK.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që të merren veprimet e duhura për të adresuar urgjentisht problemet e përmendura më lartë, në mënyrë që komuna të ketë të vendosur një strukturë të pershtatshme dhe mirë-organizuar.	Komuna nuk e ka zbatuar këtë rekomandim, situata është e njëjtë me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të sigurojnë së paku dosje me të dhëna themelore për zyrtarët e paguar nga buxheti i komunës, si dhe raporte mujore mbi vazhdimësinë/praninë në punë, për të siguruar se janë paguar vetëm punëtorët e ligjshëm të cilët ofruan shërbime.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen vendimet në fuqi për limitet e përcaktuar për shfrytëzimin e mbushjeve për telefon. Nëse paraqitet nevoja për rritjen e limit të shpenzimeve për telefon atëherë duhet të ndërmerren veprime për rishikim të vendimit i cili duhet të jetë në përputhje me menaxhimin e mirë financiar dhe kujdesin e duhur në shpenzimin e parasë publike. Gjithashtu, furnizimi me kartela të behet vetëm në bazë të nevojave për shpenzim jo për të krijuar stoqe të pa nevojshme.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar

8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale dhe komisionet janë kompetente për të mbajtur dëshmi dhe ofruar raporte të sakta për mallrat e pranuar, shpërndara si dhe të ketë raport të saktë sa i përket gjendjes së mbetur.	Komuna kishte marrë masa për ta adresuar këtë çështje.	I zbatuar
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që pagesat për shpenzimin e ujit të bëhet vetëm për faturat të specifikuar dhe të tregojn të dhëna të qarta për koston e klienteve individualisht.	Komuna nuk e ka zbatuar këtë rekomandim, situata është e njëjtë me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat ligjore për përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve janë përmbushur dhe se plani i raportohet ZK-së brenda afatit të caktuar.	Komuna nuk e ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë planin vjetor për subvencione në zyrën kompetente për qeverisje të mirë në ZK dhe të njëjtin plan nuk e ka publikuar në web faqen e komunës. Komuna ka filluar publikimin e shpalljeve publike për ndarjen e subvencioneve në media elektronike.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themelojë NjAB, me qëllim që të ofrojë mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e Komitetit të Auditimit i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.	Komuna nuk e ka zbatuar këtë rekomandim, situata është e njëjtë me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nebojsa Ristić, Udhëheqës i ekipit



Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi



ZYRA ADMINISTRATIVE E MITROVICËS SË VERIUT ADMINISTRATIVNA KANCELARIJA SEVERNE MITROVICE NORTH MITROVICA ADMINISTRATIVE OFFICE			
Nëna Org. Org. Jektiva Org. Unit	01	No Prot. Evoj Prot. Protok.	62-031
No i Regjistrimit Evoj NIVINIA Regjistrimi	01	Data Datim: Date:	04.05.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Opština Severna Mitrovica
Komuna e Mitrovicës së Veriut
Municipality of Mitrovica North

LETËR KONFIRMIMI

Në pajtueshmëri me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për Raportin e Auditimit për vitin 2021 si dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj letre konfirmojmë se:

- e kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës së Veriut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk asnjë koment lidhur me përmbajtjen e raportit dhe do të
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit Përfundimtar, do ta dorëzoj planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Milan Radojević
Kryetar i komunës Mitrovicë e Veriut,
04.05.2022, Mitrovicë e Veriut



Faqe 1 nga 1

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.